

NEWSLETTER

Gusht



ALBSIG

PJESË E  KASTRATI GROUP

KPGJT,
Ulje Tarifash
Shkollore për
Abonentët
e Vodafone

Diamant Merhati,
student i KPGJT
që ka nisur të “kurojë”
kamionat
e tonazheve të rënda

Apeli i Klientes së Shëndetit:
Kushdo, që do të Investojë
në një Sigurim Shëndeti
të Vetes apo Familjes,
ka Investuar
në të Ardhmen e Jetës

Enea Asllani,
student i KPGJT
që ka nisur
të bëhet këshilltar
i shërbimeve korrekte
në Mercedes Benz

**“Kupa e Shqipërisë Korçë 2023”
në Çiklizëm, 2 Ditë Gara në Juglindje të Vendit,
Aktivitet i Mbështetur nga Albsig**

Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, ushtron aktivitet të suksesshëm që nga viti 2004, në cilësinë e siguruesit të Jo - Jetës. Me një rrjet me 28 degë, Albsig mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë. Albsig mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor.

VIZIONI

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.

MISIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.

FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.



Partneri juaj i sigurtë!




PJESË E  KASTRATI GROUP

KPGJT, Ulje Tarifash Shkollore për Abonentët e Vodafone.



Hej, këtë herë dhurojmë 100€ ulje nga tarifa vjetore e regjistrimit në KPGJT për të gjithë të interesuarit që janë abonent të Vodafone dhe paraqiten për t'u regjistruar me kuponin e Vodafone. KPGJT vjen me një ofertë shpërblyese për të gjithë të interesuarit për të ndjekur studimet pranë këtij kolegji. Shpërblimet e kësaj oferte do të shkojnë direkt në xhepin e "studentëve". Të gjithë të interesuarit që do të jenë kontigjent i ardhur si abonent i Vodafone, do të fitojnë mundësinë e uljes në tarifën vjetore deri në 100€. Për të fituar uljen prej 100€ mjafton të jeni klient i Vodafone dhe të respektoni të gjitha udhëzimet e dhëna për regjistrim. Kolegji Profesional Gjerman i Lartë i Teknologjisë është një institucion i arsimit të lartë që promovon individë dhe i orienton ata drejt vlerave të vërteta të tregut të punës. Kolegji Gjerman Profesional i Teknologjisë, i cili shënon vitin e dytë në treg, ka nisur të përgatisë profesionistë të kualifikuar të Teknologjisë së Automobilëve, Elektromekanikës, Elektronikës, Menaxhimit të Ndërtimit, Elektrikës si dhe të Sistemeve të Ajrit të Kondicionuar dhe ka filluar të kërkohet shumë nga të rinjtë. Nuk janë vetëm rezultatet në shkollë ato që përcaktojnë të ardhmen e studentëve. Është vullneti për të ecur përpara, përkushtimi dhe serioziteti për t'u përmirësuar çdo ditë. Kolegji Profesional Gjerman është nismë e Grupit Kastrati, si përgjigje e nevojës tepër të madhe të tregut të punësimit për profesionistë të kualifikuar dhe me përvojë pune në fushën e teknologjisë. Risia e këtij kolegji profesional është metoda e arsimit dual, ndërthurja e teorisë me praktikën, gjë e cila garanton punësim të menjëhershëm pas përfundimit të shkollës.






“Kupa e Shqipërisë Korçë 2023” në Çiklizëm, 2 Ditë Gara në Juglindje të Vendit, Aktivitet i Mbështetur nga Albsig.

Në juglindje të vendit u zhvillua “Kupa e Shqipërisë Korçë 2023” për çiklizëm, organizuar nga Federata Shqiptare e Çiklizmit, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe bashkitë e qarkut të Korçës. Njëkohësisht mbështetur dhe nga një numër i konsiderueshëm biznesesh, ku ndër to ishte dhe Albsig, pjesë e Kastrati Group. Fitues i etapës së parë u shpall Olsian Velia i ekipit të Tiranës për kategorinë Elita, ndërsa Jorid Gjoka i ekipit të Partizanit preku i pari vijën e finishit për kategorinë Kadet. Në të dyja disiplinat pjesëmarrës janë 55 çiklistë nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut, aktivitete që sipas Presidentit të Federatës së Çiklizmit nxisin rininë të merret me aktivitete sportive e për t’u larguar nga veset. Juglindja e vendit po zhvillon mjaft veprimtari sportive. Pak ditë para garave të çiklizmit u zhvillua edhe Maratona Enkelana, evente këto që sipas prefektit të qarkut të Korçës Nertil Jole, jo vetëm gjallërojnë jetën në këto qytete, por edhe promovojnë natyrën e bukur të vendit. “Kupa e Shqipërisë Korçë 2023” për çiklizëm zhvillohet 2 ditë. Për mbarëvajtjen e saj u angazhua edhe policia e Qarkut të Korçës, e cila mori masa me qëllim rritjen e parametrave të sigurisë rrugore dhe sigurimin e trafikut të lirë dhe pa rreziqe për garuesit. Prefekti i Qarkut Korçë, Nertil Jole ka uruar Federatën e Çiklizmit dhe presidentin e saj, Skënder Anxhaku, për këtë organizim që nxit njerëzit të duan sportin, lëvizjen dhe aktivitetin fizik, por edhe që promovon natyrën e mrekullueshme të qarkut Korçë.





PJESË E  KASTRATI GROUP



Bli Online Kudo dhe Kurdo

 albsig.al

Apeli i Klientes së Shëndetit Kushdo, që do të Investojë në një Sigurim Shëndeti të Vetes apo Familjes, ka Investuar në të Ardhmen e Jetës.

Është një ndër klientet më të rregullta të Sigurimit të Shëndetit. Sigurimin e Shëndetit tashmë e ka vlerësuar si një ndër shtyllat kryesore të lumturisë në çdo familje shqiptare. Përvojën me Albsig e vlerëson si një ndër përvojat më të vyera të deritanishme. Jo vetëm kaq, por u bën apel gjithë njerëzve që të pajisen me Sigurimin e Shëndetit sepse vetëm kur kalon përvoja shëndetësore ja kupton më shumë vlerën e tij. Në një intervistë për Newsletter-in e Albsig, Arjeta Leka, tregon me detaje përvojën e saj si kliente shëndeti. Jo vetëm kaq, por sipas saj, shqiptarët edhe pse kanë kaluar pandeminë, përsëri tregojnë se janë një popullatë neglizhente jo vetëm ndaj kujdesit shëndetësor, por edhe ndaj masave për garantimin e tij. Në një intervistë ajo tregon me detaje hapat që ka ndjekur për t'u pajisur me sigurimin privat të shëndetit.

1. Kur jeni siguruar për herë të parë dhe kush u bë shkaku që ju u pajisët me sigurim?

Falë profesionit tim unë kam mundur të përfitoj edhe këtë shërbim. Kam qenë për shumë vite e siguruar nga kompania ku punoj dhe kam marrë shërbim nga Shoqëri të ndryshme sigurimi, që janë prezente në tregun shqiptar.

2. Shoqërinë Albsig ua sugjeroi ndonjë i njohur nga ana juaj apo e përcaktuat vetë?

Siç edhe e thashë më lart falë profesionit tim kam përfituar edhe këtë mundësi të jem pjesë e pandashme e paketave të sigurimit të shëndetit. Vetëm pas një eksperience jo të pëlqyeshme me shoqërinë e mëparshme të sigurimit, kompania jonë zgjodhi të radhës Shoqërinë Albsig. Për mua ishte eksperiencia e parë me Albsig. Në fillim ngaqë nuk kishim përvojë të mëparshme e kishim disi me frikë marrëdhënien, se kur vjen puna te shëndeti gjërat shikohen ndryshe. Gjithsesi përcaktimi i Albsig duket se ka qenë i duhuri për stafin ku unë punoj pasi deri tani kemi një marrëdhënie shumë korrekte.





3. Si është përvoja juaj e të qenurit e siguruar si familje?

Të jesh e siguruar familjarisht, sidomos kur je prind, është kaq e nevojshme. Të dish që ke një Shoqëri Sigurimi pas vetes në çdo rast, të sjell një ndjesi sigurie dhe qetësie për të ardhmen e panjohur dhe me pak fjalë dua të theksoj se një ndër çelësat e sigurisë së një familje është të jesh i siguruar në një kompani siç është Albsig.

4. Si ishte përvoja juaj e parë me Albsig?

Në fillim ishim disi të tërhequr. Edhe pse mungesa e edukimit mbi sigurimet ka lënë pasojat e saj, në zhvillimin e kësaj fushe çdo gjë ka ndryshuar për mirë. Njerëzit janë ndërgjegjësuar dhe kanë kuptuar rëndësinë e shëndetit. Duke patur eksperiencën të mëparshme nga Shoqëritë e tjera të sigurimit, përvoja me Albsig ishte impresionuese që në kontaktin e parë. Komunikimi korrekt dhe përgjigja në kohë rekord ishin dy gjërat e para që më bënë përshtypje. Më pas u bë shkak një ndërhyrje kirurgjikale tek djali im që unë të kisha një eksperiencë më intensive me Albsig. Jam ndjerë, pak të thuash, njeriu më me fat atë natë. Kam marrë suportin e menjëhershëm në orët e vona të fundjavës, edhe pse stafi ishte pushim.

5. A morët shërbimin e duhur?

Po të kisha një mundësi vlerësimi do t'i jepja hakun që meriton si shoqëri. Deri tani kam marrë shërbim me 5 yje në çdo moment që kam patur nevojë. Jam shumë mirënjohëse për këtë shërbim që më kanë dhënë.

6. Një apel për familjet shqiptare për t'u pajisur me Sigurim Shëndeti?

U kam folur shumë miqve, kolegëve dhe familjarëve për eksperiencën time me Albsig, si një nga eksperiencat më të mira që kam patur me Shoqëritë e Sigurimit. E rekomandoj fort dhe u bëj apel kujtdo, që të investojnë në një sigurim të vetes apo familjes, sepse atëherë kur nuk ta pret mendja, është drita në fund të tunelit.



Diamant Merhati, student i KPGJT që ka nisur të “kurojë” kamionat e tonazheve të rënda.

Trup sportiv, e dukjen e një djali kopertinash. Edhe pse ka qenë poshtë kamionit ai sërish ka shumë detaje që e diferencojnë me të tjerët. Edhe pse shumë vapë, kapelen nuk e heq nga koka, jo vetëm për të mbrojtur flokët e gjata e të stiluar bukur, por hera herë i duhet të mbrohet dhe nga dielli. Diamanti, siç ka emrin ka dhe sjelljen. Është shumë i shkathët, këmbëngulës dhe i artikuluar. Madje po të qëndrosh pak minuta në sallonet e Autostar Abania, Diamantin e shikon kudo. Këmbëngul të mësojë dhe është punëmbarruar në të gjitha detyrat që është orientuar nga mjeshtërit e vjetër të servisit.

“Dua të punoj dhe e di se vetëm me punë mund t’ia dal. Unë i kam patur me pasion makinat që i vogël dhe për këtë arsye kam menduar që pasionin tim ta kthej në profesion”.

Kështu nis rrëfimin e tij të veçantë Diamant Merhati, student i KPGJT. Ka pak muaj që është emëruar si Asistent Teknik i Sistemeve, me fjalë të tjera, është “kirurg” për kamionët e rëndë.

Si u bërë pjesë e KPGJT?

Si çdo i ri edhe unë jam i apasionuar pas makinave. E kisha ndarë mendjen që do të vazhdoja një shkollë të tillë. Fakti që KPGJT kishte një eksperiencë me standarde evropiane dhe me perspektivë për të ardhmen, u joshë menjëherë nga ofertat që pashë në TV. Më pas vajta vetë pranë zyrave të KPGJT, ku e pashë më nga afër dhe mundësinë e shkollimit. Jam shumë i lumtur që kam bërë zgjedhjen e duhur dhe për këtë ju bëj thirrje të gjithë të rinjve që kanë pasion makinat dhe jo vetëm, të zgjedhin KPGJT sepse vetëm kjo zgjedhje ju bën të mundur të filloni mbarë karrierën në fushën e automobilave.

Si ka qenë viti i parë i shkollës në KPGJT?

Duke qenë përvojë e re, e realizuar për herë të parë në Shqipëri me nismë të Grupit Kastrati, ne mundëm të përfitojmë në vitin e parë të shkollës. Gërshetimi i teorisë me praktikën, realizimi i praktikave nëpër firmat e Kastrati Group dhe mundësia për t’i prekur vetë çdo pjesë të automjeteve, na bëri që ne të përpiqeshim edhe më shumë për të marrë njohuritë e duhura si në teori, ashtu edhe në praktikë. Realizimi i praktikave profesionale në firmat më me zë në Shqipëri, përdorimi i metodave efikase na fuqizoi edhe ne drejt rrugës së suksesit që tashmë kemi ndërmarrë. Kushtet mësimore, stafi akademik i përzgjedhur me shumë kujdes, bëri që ne të jemi shumë të vëmendshëm dhe të profilizohemi në degët

e përzgjedhura.

Si ishte vijimësia e praktikave mësimore dhe mundësia për punësim?

Shkolla ofron mësim me pedagogë dhe ekspertë nga Gjermania, Zvicra, Austria, etj., të cilët kanë përdorur kurrikula të përditësuara sipas standardeve evropiane. Rëndësia e shkollave të tilla profesionale në vendin tonë është tepër e madhe, pasi ndihet një mungesë e theksuar e fuqisë punëtore me aftësi profesionale teknike ndërkohë që bizneset shqiptare synojnë të arrijnë nivelet dhe standardet bashkëkohore.

Si u bërë pjesë e Mercedes Benz Autostar Albania?

Pas mbarimit të vitit të parë të studimeve në KPGJT dhe pas praktikës profesionale, domethënë pasi morëm bazat tona në profilin që kemi përzgjedhur, mua më kërkuan në intervistë përfaqësuesit e Autostar Albania. Intervista ishte dhe përcaktuese e menjëhershme e mundësisë për punësim si Asistent Teknik i Sistemeve të kamionave. Kam pak muaj që gëzoj statusin si i punësuar në servisin e kamionëve të Autostar Albania. Jam shumë i apasionuar pas punës dhe dua që të specializohem dhe të marr trajnimet e duhura në fushën që tashmë kam startuar. Jam shumë falenderues ndaj stafit akademik të KPGJT si dhe Kastrati Group që më bëri pjesë të një prej kompanive më të dëshiruara për çdo të ri në Shqipëri siç është Mercedes Benz. Një ëndërr që mu bë realitet ishte emërimi i menjëhershëm në punë në profesionin që unë dëshiroja. I bëj thirrje çdo të riu shqiptar që të zgjedhë KPGJT, sepse vetëm falë punës dhe përkushtimit dhe mbështetjes së Kastrati Group gjithësecili do t’ia dalë ashtu si edhe unë.

Ku e shikon veten pas mbarimit të Kolegjit Profesional Gjerman të Teknologjisë?

Jam shumë i lumtur dhe shumë falenderues ndaj Grupit Kastrati për mundësinë që më dha për punësim në një prej firmave më prestigjioze siç është Mercedes Benz. Për momentin jam shumë i lumtur që arrita të realizoj ëndrrën time duke marrë profesionin e ëndërruar dhe duke punuar sa më shumë për t’u plotësuar në profesionin që kam startuar. I falenderoj shumë drejtuesit që më përzgjedhën dhe më dhanë mundësi të punoj në serviset më të mira të Mercedes Benz në Shqipëri. Për momentin e shikoj veten duke punuar fort në fushën që tashmë kam përzgjedhur dhe në të ardhmen të kem mundësi të arta dhe të jem kudo, jo vetëm brenda por dhe jashtë vendit.



Enea Asllani, student i KPGJT që ka nisur të bëhet këshilltar i shërbimeve korrekte në Mercedes Benz.

Autosalloni i Mercedes Benz është i mbushur me njerëz dhe automjete të viteve të fundit. Mes mercedesave të rinj shikon shefat e shitjeve të shoqëruar nga klientë që shkëmbejnë mundësitë dhe ofertat e blerjeve të verës. Salloni i automjeteve të reja të bie në sy për një pastërti të pashoqe. Edhe pse ka shumë klientë, xhamat e makinave dhe të sallonit shkëlqejnë. Ndërkaq ajo që të bie më shumë në sy është pjesa tjetër e Mercedes Benz Autostar Albania, pjesa e shërbimit të klientëve. Që në tavolinën e parë të pritjes shikon një djalë të ri, korrekt në pritje dhe në komunikim me klientët, të cilët presin të kryejnë shërbimet e makinave.

“Ju lutem mund të shikoj dokumentacionet që duhen dhe të shikoj dhe shërbimet e fundit që i janë bërë mjetit?”, i drejtohet klientit një djalë i ri. Bëhet fjalë për Enea Asllanin, Student i KPGJT, i cili ka spikatur si këshilltar shërbimi, Service Advisor. Studenti i KPGJT në një rrëfim të shkurtër do të na tregojë të gjithë rrugëtimin e tij më shumë se një vjeçar nga kolegji në vendin e punës që tashmë ai gëzon.

Si u bërë pjesë e KPGJT?

Si çdo i ri edhe unë isha i apasionuar shumë pas makinave. Dhe jo vetëm kaq, por kisha shumë pasion montimin dhe çmontimin e çdo gjëje që kishte të bënte me vida e butona. E kisha vendosur të shkoja në një shkollë profesionale të Teknologjisë së Automobilëve, dhe pas ofertës së KPGJT i joshur dhe nga përvoja gjermane vendosa të regjistrohem direkt në degën që kisha ëndërruar. U bëmë thirrje të gjithë të rinjve që të bëhen pjesë e Kolegjit pasi e ardhmja e tyre do jetë e sigurt në tregun e punës sot në Shqipëri.

Si ka qenë viti i parë i shkollës në KPGJT?

Jam shumë i kënaqur me të gjithë përvojën akademike dhe profesionale që kam marrë deri tani. I bëj thirrje të gjithë të rinjve që të bëhen pjesë e KPGJT sepse vetëm në këtë kolegji mund të bëhet ëndrra realitet. Viti i parë nisi qetësisht dhe ne ishim paksa të pa mësuar me përvojën akademike dhe praktikën profesionale që morëm përgjatë gjithë vitit. Ajo çfarë e bëri më shumë atraktive eksperiencën mësimore në vitin e parë ishin praktikat profesionale. Jam tejet falenderues që u bëra pjesë e KPGJT, një nismë kuptimplote për të rinjtë e realizuar nga Kastrati Group.

Si ishte vijimësia e praktikave mësimore dhe mundësia për punësim?

Stafi i KPGJT, stafi më i mirë - një kombinim brezash e përvojash të shquara akademike dhe profesionistë të rinj të orientuar drejt praktikës. KPGJT është i vetmi institucion arsimor që ka laboratorë modernë, ofiçina dhe programe që stimulojnë praktikën në terren për një kombinim sa më efektiv të teorisë me zbatimin praktik të dijeve të marra. Kolegji Gjerman Profesional i Teknologjisë, përveç përgatitjes së një stafi të kualifikuar teknik, do t'i vijë në ndihmë edhe kompanive të tjera në vend që do të kenë dëshirë për të trajnuar dhe aftësuar stafin e tyre, duke nxitur frymën e bashkëpunimit dhe duke dhënë kontribut domethënës në zhvillimin profesional të vendit. Kolegji Gjerman Profesional i Teknologjisë, është tashmë në proces akreditimi dhe do të ofrojë programe studimi të mbështetura në përvojën dhe praktikën me të mira të vendeve evropiane dhe sipas kriterëve të sistemit të Bolonjës, të vlerësuara me ECTS. Studentët e këtij kolegji do të kenë në dispozicion teknologjinë më të fundit në të gjitha fushat ku do të përgatiten, me laboratorë mësimorë, si dhe me praktikën në terren në disa prej bizneseve më të suksesshme në Shqipëri.

Ku e shikon veten pas mbarimit të Kolegjit Profesional Gjerman të Teknologjisë?

Veten e shikoj në të ardhmen në Shqipëri dhe dua që të prefeksionohem në pozicionin që më është besuar në Mercedes Benz Autostar Albania. I jam falenderues Kastrati Group për mundësinë që më ka dhënë dhe jam përkushtuar totalisht që të marr njohuritë e duhura që të aftësohem dhe të ngjis shkallët e ekspertëve të fushës. Njëkohësisht jam tejet i lumtur që jam pozicionuar aty ku doja dhe besoj se ëndërra ime po bëhet realitet. U bëj thirrje të gjithë moshatarëve të mi që të bëjnë përzgjedhjen e duhur ashtu siç bëra dhe unë, të zgjedhin KPGJT pasi vetëm falë këtij kolegji do të kenë mundësi shkollimi e punësimi në profesionet më të kërkuara.

Stafi i KPGJT, stafi më i mirë!



☎ +355 (0) 42254770 / 764

✉ info@albsig.al

WWW.ALBSIG.AL